



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 43/3 prot.

Tiranë, më 24.02.2026

VENDIM

Nr. 07, datë 24.02.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), formularin e ankesës nr. 3097 Prot., datë 02.12.2025 me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Shoqëria “Korporata e Investimeve Shqiptare” Sh.A. (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesës datë 13.11.2025, depozituar në adresën elektronike grei.flamuraj@aiccorporation.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Kopje të buxhetit të Korporatës për vitet 2020-2025;*
2. *Një kopje të buxhetit të zbatuar të Korporatës për vitet 2020-2024 me zbërthimet përkatëse për shpenzimet e kryera, bazuar në zërat specifike të buxhetit;*
3. *Nga data e themelimit të Korporatës e deri më sot, kush kanë qenë anëtarët e Këshillit të Mbikëqyrjes së saj dhe sa ka qenë gjatësia e pozicionit të tyre?*
4. *A ka pasur dhe nëse po, sa ka qenë shpërblimi për angazhimin e këtyre anëtarëve? Po kërkoj shumat specifike të paguara nga buxheti i Korporatës për çdo individ dhe në total në bazë vjetore, jo vetëm shumën e parashikuar në listpagesën e shpërblimeve për postin.*
5. *Nga data e themelimit të Korporatës e deri më sot, kush kanë qenë anëtarët e Bordit Këshillimor të saj dhe sa ka qenë gjatësia e pozicionit të tyre?*

6. A ka pasur dhe nëse po, sa ka qenë shpërblimi për angazhimin e këtyre anëtarëve? Po kërkoj shumat specifike të paguara nga buxheti i Korporatës për çdo individ dhe në total në bazë vjetore, jo vetëm shumën e parashikuar në listpagesën e shpërblimeve për postin.

Autoritetit Publik, me e-mail-in datë 24.11.2025, ka kthyer përgjigje duke referuar linkun e Programit të Transparencës <https://www.aicorporation.al/sp/programi-i-transparences> në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

Ankuesi, pas përgjigjes së Autoritetit Publik, me pretendimin se nuk i është vendosur në dispozicion informacioni i plotë sipas pikave të kërkesës, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 3097/1 Prot., datë 04.12.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 11.12.2025.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 568/1 Prot., datë 15.12.2025, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 3097/2 Prot., datë 15.12.2025, ka rivlerësuar kërkesën për informacion, duke sqaruar ndër të tjera se *informacioni dhe të dhënat mbi buxhetin e Korporatës së Investimeve Shqiptare ndër vite gjendet në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, rubrika “Kërko për subjekt në regjistrin tregtar” dhe tek ekstrakti historik i Korporatës mund të shkarkohen të gjitha pasqyrat financiare, raportet e auditit, raportet e ecurisë së veprimtarisë së drejtimit dhe pagesave që nga data e themelimit. Në lidhje me anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, lista e plotë me emrat e anëtarëve që nga themelimi i Korporatës e deri më sot, kohëzgjatja e emërimit të tyre si dhe të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur me anëtarët ndër vite gjendet në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, rubrika “Kërko për subjekt në regjistrin tregtar” ku mund të shkarkohet dhe ekstrakti historik i Korporatës, në linkun <https://qkb.gov.al/kerko-per-subjekt/>. Shpërblimet e anëtarëve të Këshillit janë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” si dhe Statutit të Korporatës së Investimeve Shqiptare të cilat i gjeni në linkun <https://www.aicorporation.al/sq/rreth-nesh/ligjet-dhe-rregulloret>”.*

Në vijim, ankuesi bazuar dhe në kërkesën e Autoritetit Publik, për qartësim të informacionit të kërkuar, me e-mail-et datë 16.12.2025 dhe datë 23.12.2025, ka vijuar ankimin duke saktësuar objektin e kërkimit konkretisht për pikat 3, 4, 5 dhe 6 të kërkesës për informacion.

Në këto kushte, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 16.01.2026, me prezencën e palëve, të ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik, znj. Grei Flamuraj, me detyrë koordinatore për të drejtën e informimit dhe znj. Enida Myhedini, me detyrë Specialist Ligjor i Divizionit Ligjor dhe Përputhshmërisë.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër, duke argumentuar se kërkesa e tij për informacion, edhe pse tërësisht e bazuar në ligj, vijon të jetë e papërbushur nga Autoriteti Publik. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, në pretendimet e parashtruara gjatë seancës, rikonfirmuan qëndrimin e mbajtur në kthim përgjigjet e sipërcituara, duke e konsideruar të përmbushur qëllimin e LDI. Në përfundim të seancës dëgjimore përfaqësuesit e Autoritetit Publik konfirmuan se ishin personat përgjegjës që kishin trajtuar ankesën, si dhe bazuar në sqarimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, Autoritetit Publik iu la afat të rishikonte qëndrimin e mbajtur brenda datës 20.01.2026.

Në vijim, Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 19.01.2026, ka kthyer përgjigje duke vendosur në dispozicion ekstraktin historik të datës 19.01.2026, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Pas përgjigjes së sipërcituar të Autoritetit Publik, ankuesi me e-mail-et datë 20.01.2026 dhe datë 27.01.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 43/1 Prot., datë 20.01.2026 dhe nr. 43/2 Prot., datë 27.01.2026, ka vijuar ankimin për pikat 4 dhe 6 të kërkesës për informacion, duke kërkuar përmbushjen e detyrimit nga Autoriteti Publik për dhënien e informacionit për këto pika.

Pas konsultimit të legjislationit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 2 të LDI parashikohet se: “*Autoritet publik*” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislationin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj; b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës “c” të kësaj pike; c) çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislationi në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike”.

Nga verifikimi i kryer në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, rezulton se Korporata e Investimeve Shqiptare është Shoqëri Aksionare me kapital 100% shtetëror, që ka si objekt të veprimtarisë *Nxitjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet projekteve të investimit me potencial komercial në nivel qendror, vendor dhe rajonal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit, etj.*

Në këtë kuptim, Korporata e Investimeve Shqiptare Sh.a. është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”*. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Në lidhje me pretendimin e Autoritetit Publik se: *Shpërblimet e anëtarëve të Këshillit janë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare” si dhe Statutit të Korporatës së Investimeve Shqiptare të cilat i gjeni në linkun <https://www.aicorporation.al/sq/rreth-nesh/ligjet-dhe-rregulloret>*, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, pasi në ligjin material dhe në Statutin e Korporatës përcaktohet në parim mënyra e shpërblimit të anëtarëve dhe nuk përcaktohet shuma e shpërblimit, sipas objektit të kërkesës për informacion.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.20228 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, çdo subjekt tregtar apo person fizik a juridik, i regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka detyrimin që në Ekstraktin Historik në Regjistrin Tregtar për të Dhënat e Subjektit të deklarojë dhe përditësojë të dhënat e tij, të përmbushë detyrimet ligjore, tatimore dhe financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, etj. Ndërkohë, informacioni i kërkuar është informacion specifik dhe nuk evidentohet nga ekstrakti historik në Regjistrin Tregtar të Shoqërisë Aksionare të Korporatës së Investimeve Shqiptare, të vendosur në dispozicion nga autoriteti publik në kthim përgjigjen datë 19.01.2026.

Po ashtu, në vijim të pretendimit të autoritetit publik sqarojmë se, LDI, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) *informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar*. Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vendosen në dispozicion nga autoriteti publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti (sipas pikës 1 të nenit 7 të LDI), ndërsa rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë të informacionit, pasi kemi të bëjmë me një kërkesë për informim të depozituar pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI.

Ndërkohë, LDI rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij gjithashtu përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Pikërisht, është pika 6 e nenin 17 të ligjit të sipërcituar, e cila përcakton se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*. Rezulton se, Autoriteti Publik në asnjë rast, në lidhje me dokumentacionin e kërkuar, nuk ka argumentuar apo të bënte një analizë të mirëfilltë, në lidhje me mosdhënien e informacionit sipas kësaj dispozite.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”*. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI.

Në çdo rast, pagat dhe shpërblimet e funksionarëve publikë konsiderohen informacion publik, pasi lidhen drejtpërdrejt me përdorimin e fondeve publike dhe ushtrimin e funksioneve publike. Vendosja në dispozicion të kërkuarëve dhe/ose publikimi i këtyre të dhënave është i nevojshëm për të garantuar transparencën dhe llogaridhënien e administratës ndaj qytetarëve. Të ardhurat që burojnë nga funksioni publik, përfshirë pagën dhe shpërblimet, nuk konsiderohen të dhëna personale private dhe nuk gëzojnë mbrojtje nga ligji nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, për këtë arsye duhet të jenë të aksesueshme për publikun. Për rrjedhojë, kërkesa për informacion mbi pagat dhe shpërblimet e funksionarëve publikë është e ligjshme dhe institucioni ka detyrimin për t’i bërë këto të dhëna të aksesueshme për publikun, duke qenë se nuk ka asnjë pengesë ligjore për mosdhënien e tyre.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave, sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe deklarimit të përfaqësuesve të Autoritetit Publik gjatë seancës dëgjimore për marrjen e përgjegjësisë të trajtimit të ankesës, Komisioneri konstaton se, znj. Greqi Flamuraj, me detyrë Koordinatorë për të drejtën e informimit dhe znj. Enida Myhedini, me detyrë Specialist Ligjor i Divizionit Ligjor dhe Përputhshmërisë pranë Autoritetit Publik, janë personat përgjegjës të cilat nuk kanë përmbushur detyrimin për kthimin e përgjigjes së kërkesës për informacion, rrjedhimisht kanë refuzuar dhënien e informacionit.

Në këto kushte, bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 të LDI, *refuzimi për dhënien e informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë deri në*

300.000 (treqind mijë) Lekë.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Bazuar në pikën 3, të nenit 3 e LDI parashikon se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 18, pikën 3 të nenit 18, pikën 4 të nenit 19, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22, shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. _____, me nr. 3097 Prot., datë 02.12.2025, ndaj Autoritetit Publik, Shoqëria “Korporata e Investimeve Shqiptare” Sh.A., me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”;
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit për pikat 4 dhe 6 të kërkesës për informacion datë 13.11.2025, konkretisht: “4. A ka pasur dhe nëse po, sa ka qenë shpërblimi për angazhimin e këtyre anëtarëve? Po kërkoj shumat specifike të paguara nga buxheti i Korporatës për çdo individ dhe në total në bazë vjetore, jo vetëm shumën e parashikuar në listpagesën e shpërblimeve për postin. 6. A ka pasur dhe nëse po, sa ka qenë shpërblimi për angazhimin e këtyre anëtarëve? Po kërkoj shumat specifike të paguara nga buxheti i Korporatës për çdo individ dhe në total në bazë vjetore, jo vetëm shumën e parashikuar në listpagesën e shpërblimeve për postin.”, brenda datës 06.03.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2024 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
3. Dënimin e znj. Grei Flamuraj, në cilësinë e koordinatorit për të Drejtën e Informimit, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoha ekzekutohet nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me

- nenin 23 të ligjit të sipërcituar, në tejkalim të afatit të përmendur, sanksioni administrativ përbën titull ekzekutiv;
4. Dënimin e znj. Enida Myhedini, me detyrë Specialist Ligjor i Divizionit Ligjor dhe Përputhshmërisë, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoba ekzekutohet nga Drejtoria e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar, në tejkalim të afatit të përmendur, sanksioni administrativ përbën titull ekzekutiv;
 5. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 2, pala ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
 6. Kundër vendimmarrjes në pikat 3 dhe 4, personat ndaj të cilëve është vendosur sanksioni administrativ, kanë të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
 7. Ky vendim u shpall sot në datë 24.02.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi